



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 22, datë 27.02.2020

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 16, 17, 48 dhe 49 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 4, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a. si rezultat i zmadhimit të kapitalit, si më poshtë:

“Kapitali themeltar i shoqërisë është 834,305,000 lekë, i ndarë në 83,430 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10,000 lekë secili, sipas strukturës më poshtë:

<i>Numri i aksioneve</i>	<i>83,430</i>	
<i>Vlera nominale e aksioneve</i>	<i>10,000</i>	
<i>Piro Angjeli</i>	<i>56,732</i>	
<i>Llazar Angjeli</i>	<i>18,355</i>	
<i>Edlir Ruka</i>	<i>8,343</i>	
<i>Z. Piro Angjeli</i>	<i>Vlera në lekë</i>	<i>567,327,400</i>
	<i>Pjesëmarrja në %</i>	<i>68%</i>
<i>Z. Llazar Angjeli</i>	<i>Vlera në lekë</i>	<i>183,547,100</i>
	<i>Pjesëmarrja në %</i>	<i>22%</i>
<i>Z. Edlir Ruka</i>	<i>Vlera në lekë</i>	<i>83,430,500</i>
	<i>Pjesëmarrja në %</i>	<i>10%.,,</i>

2. Miratimin e z. Llazar Angjeli, zotërues i 22% të kapitalit të shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a., si aksionar influencues.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI